

EC
MA NDRYSHE



EKO SHKOLLA

- REDUKTO - RIPËRDOR - RIKIKLO -

EKO KLUBI

"12 MAJI"

2



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

CARITAS Schweiz
Suisse
Svizzera
Svizra

YENI YOUTH
ENVIRONMENTAL
IMPACT



Të dashur lexues,

Kjo është seria e dytë e buletineve mjedisore të eko-klubeve të shkollave të mesme nga Rajoni i Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës). Ky është buletini i parë informativ, i cili do të përmbajë mesazhe, intervista, ese, punime fotografi dhe shkrime të ndryshme mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe njoftime mbi punën që po zhvillohet në këto tema nga eko-klubi i Shkollës së Mesme të Lartë “12 Maji” dhe OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit “ECO School”.

Ky projekt do t’i njohë me konceptin “Eko Shkolla” 12 shkollat e rajonit të Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës), përmes pilotimit të formave dhe metodologjisë për mbrojtjen e mjedisit me pjesëmarrje të gjerë të nxënësve dhe mësimitdhënësve.

Në kuadër të projektit ofrohet një model dhe metodologji që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara, e cila po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, e cila nxit të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyre aktive.

Projekti po ashtu do të kontribuojë në Strategjinë e Mjedisit dhe Planin e Veprimit në Mjedis të Kosovës, duke rekomanduar zhvillimin e programeve për edukimin mjedisor në të gjitha nivelet (shkolla dhe universitete).

SI TA MBROJMË MJEDISIN JETËSOR?

Të gjitha gjallesat që jetojnë në këtë tokë janë të varur nga mjedis. Pavarësisht nëse jetojnë në tokë apo ujë ata janë pjesë e mjedisit. Mjedisi mund të kuptohet si një batanije që e mban jetën në planet të shëndoshë. Mjedisi na jep përfitime të panumërta që nuk mund t'ia paguajmë gjatë gjithë jetës tonë. Pyesim: Pse nuk mund ti'a paguajmë asnjëherë? Cili është shkaku?

Shkaku kryesor i degradimit të mjedisit janë aktivitetet njerëzore. Aktivitet njerëzore që shkaktojnë degradimin e mjedisit janë ndotja, politikat e dëmtuara mjedisore, kimikatet, gazrat serrë, ngrohja globale, sosje e ozonit etj. Të gjitha këto e dëmtojnë mjedisin shumë keq.

Po si mund të shpëtojmë mjedisin? Çka mund të bëjmë ne që mjedisi të bëhet më mirë?

Ka shumë mënyra për ta shpëtuar mjedisin, njëra që duhet kushtuar më shumë vëmendje është mbjellja e pemëve. Një pemë është burim i oksigjenit. Fatkeqësisht, për shkak të ndërtimeve janë prerë shumë pemë. Kjo sigurisht redukton sasinë e oksigjenit në mjedis.

Ruajtja e tokës është një mënyrë tjetër e rëndësishme për të shpëtuar mjedisin. Për këtë duhet të ketë kontroll të rrëshqitjeve të dheut, përmytjeve dhe erozionit të tokës.

Menaxhimi i mbetjeve është një mënyrë e fuqishme për të mbrojtur mjedisin. Duhet të ketë asgjësim të duhur të mbetjeve. Dhe shumë mënyra të tjera për ta shpëtuar atë, por bota që jetojmë tani, as nuk do të përpiqet ta bëjë një ndryshim në të dhe me kalimin e ditëve po përkeqësohet. Për më tepër, atë na ka bërë mjedisi ne në kembim vetëm e kemi dëmtuar dhe degraduar.

SI TA MBROJMË MJEDISIN JETËSOR?



Në shekullin e fundit toka ka pësuar dëme të mëdha. Prej fillimit të revolucionit industrial e deri më sot ne vazhdojmë ta shpërfillojmë. Me përdorimin e vazhdueshëm të energjisë së fosileve, ndotjen e oqeanëve dhe lirim të karbonit.

Dëmet që janë bërë ndaj mjedisit janë të mëdha dhe efektet do të jenë kolosale. Si njerëz të përditshëm gjëja më e mirë që mund të bëjmë është riciklimi, përdorimi i makinave elektrike, etj. Por si komunitet dhe shoqatë mund të përdorim energji diellore, të erës dhe gjithashtu reaktorët nuklear.

Gjithashtu një nga debatet më të mëdha në fushën e mjedisit është geo-ingjinerizimi, kjo është një çështje e komplikuar sepse rrezikon ndryshimin e planetit tonë me pasoja të pakthyeshme.

Geo-Ingjinerizimi nënkupton ndryshimin e vet planetit tonë por kësaj here me qëllim që ta shpëtoj, duke ndryshuar vet atmosferën.

Kjo mund të ketë dobishmeri në disa shtete dhe dëme në të tjerët. Prandaj duhet që e gjithë bota të mblidhet bashkë që të funksionojë pa marrë parasysh politikën e shteteve në fjalë.

SI TA RUAJMË MJEDISIN JETËSOR?



Me mjedis kuptojmë ambientin në të cilin qeniet e gjalla jetojnë dhe veprojnë, për këtë arsye duhet ta ruajmë dhe te kujdesemi për të. Mjedi si mbrohet duke dhënë secili kontributin e tij.

Duke mbajtur pastër dhe duke u kujdesur për të, për shembull : duke i hedhur mbeturinat në kosh dhe jo ne rrugë , të mbjellim pemë dhe jo ti presim, etj.

Shkaktari kryesor për ndotjen e mjedisit është vetë njeriu , njeriu është ai që duhet të vetëdijësohet sepse për të mbrojtur mjedisin duhet të fillojmë së pari vet ne.



ANDUENA MORINA XI-3- EKO KLUBI "12 MAJI"



SI TA MBROJMË MJEDISIN JETËSOR?



Ruajtja e mjedisit jetësor është shumë e rëndësishme. Disa mënyra për ta bërë këtë janë: riciklimi i mbeturinave, përdorimi i energjisë së qëndrueshme, përdorimi i transportit publik dhe mbrojtja e zonave natyrore.

Riciklimi i mbeturinave është i rëndësishëm për të ruajtur mjedisin. Ndhmon në zvoglimin e ndotjes dhe rikthimin e materialeve të ricikliushme. Është një mënyrë e thjeshtë për të ndihmuar planetin tonë.

Energjia e qëndrueshme është shumë e rëndësishme për të ruajtur mjedisin. Energjia e qëndrueshme siguron një të ardhme të pastër dhe të qëndrueshme. Përdorimi i burimeve të rinovueshme ndihmon zvoglimin e ndotjes dhe ndryshimeve klimatike. Transporti publik është një zgjidhje e shkëlqyeshme për të zvogluar ndotjen dhe trafikun.

Gjithashtu, mbrojtja e zonave natyrore është e rëndësishme për të ruajtur biodiversitetin dhe bukurinë e natyrës. Ruajtja e mjedisit jetësor është shumë e rëndësishme për të mbrojtur biodiversitetin dhe ekosistemet natyrore.

Duke ruajtur pyjet, oqeanet, liqenet dhe habitatet e tjera, ne sigurojmë që shumë lloje të kafshëve të zhvillohen. Kjo ndihmon në mbrojtjen e shëndetit të natyrës dhe mirëqenies së njerzve.

Është e rëndësishme të marrim masa për të zvogëluar ndotjen, shfrytëzimin e tepruar të burimeve natyrore dhe ndërhyrjen në habitatet natyrore.

SI TA RUAJMË MJEDISIN JETËSOR?



Një mjedis i pastër do të thotë shumë për ne, ndryshimi i disa faktorëve të mjedisit qofshin ata biologjik apo fiziko-kimik, mund të rezultojë me pasoja në shëndetin e njerëzve.

Prandaj që ne të kemi një shëndet të mirë dhe ambient të pastër duhet ta ruajmë mjedisin jetësor, mjedisi është tepër i veçantë për të gjithë ne, ambienti është ai në të cilin njeriu zhvillon veprimtarinë e tij jetësor dhe pa të nuk do të mund të ekzistonte.

Ne duhet të krijojmë mjedis ekologjik për të sotmen dhe të ardhmen.

BESA BYTYQI XI – EKO KLUBI "12 MAJI"





INAGURIMI I PROJEKTIT MJEDISOR

Në shkollën e mesme të lartë “12 Maji” në Ratkoc të Rahovecit është përfunduar projekti mjedisor i ideuar nga Eko Klubi i kësaj shkolle. Me anë të këtij projekti Eko Klubi ka rritur hapësirën e gjelbër në oborrin e shkollës, duke e shndërruar kështu atë në një zonë rekreative që do të shfrytëzohet nga të gjithë nxënësit.


Në këtë hapësirë janë mbjellur drunjë dhe bimë shumë vjeçare, është rregulluar sistemi pikë-pikë për ujitjen e drunjëve të mbjellur. Në të njëjtën kohë në muret e shkollës është realizuar edhe një mural me motive mjedisore.






AKTIVITETET E EKO-KLUBIT:

TAKIMI MES EKO-KLUBIT DHE
ËÇ MA NDRËSHE





DOKUMENTAR MJEDISOR ME EKO -KLUBET

Dokumentari mjedisor në "Kino Lumbardh" për 12 Eko - Klubet e Shkollave të Mesme të Rajonit të Jugut (Prizren, Rahovec, Malishevë dhe Mamushë). Ky aktivitet është pasuar me diskutim në mes anëtarëve të eko klubeve mbi çështjet mjedisore të trajtuara në dokumentar.


Gjatë këtij aktiviteti u shqyrtua se si veprimet tona të pakujdesshme ndaj natyrës çojnë drejt degradimit të planetit, ta bëjnë atë të pabanueshëm për miliona njerëz dhe si do të sjellin shkatërrimin e popullatave të biodiversitetit.

Ky aktivitet përveç njohurive të reja dhe aktivizimit të nxënësve për të ofruar zgjidhje të ndryshme mbi këto çështje, po ashtu kontribuoi edhe për shoqërimin e tyre duke ndarë mes vete përvojat për aktivitetet mjedisore që ata realizojnë në shkollat e tyre.





AKSION PASTRIMI NË OBORRIN E SHKOLLËS



EKO KLUBI "12 MAJI"

RATKOC, RAHOVEC, KOSOVË

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci Nr.94, Prizren & Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7,
Prishtinë

www.ecmandryshe.org

info@ecmandryshe.org

029 222 771 & 038 224 967

Ky buletin u realizua në kuadër të projektit "Ndikimi i Rinisë në Mjedis" - YENI, i cili bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Caritas-i Zviceran, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe implementohet nga OJQ EC Ma Ndryshe përmes projektit "ECO Schools".